



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**PROGRAMI KOMBËTAR I BURSAVE TË REPUBLIKËS SLOVAKE
VITI AKADEMIK 2024-2025**

Agjencia Sllovaqe Akadematike dhe Informative (SAIA), njofton mbi hapjen e aplikimeve të Programit Kombëtar të Bursave të Republikës Sllovaqe për studime, kërkime, mësimdhënie dhe art për vitin akademik 2024-2025.

Programi Kombëtar i Bursave të Republikës Sllovaqe, i cili financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Hulumtimit dhe Sportit mbështet lëvizshmërinë e studentëve ndërkombëtarë, të doktoraturës, mësuesve të universiteteve, studiuesve dhe artistëve për të qëndruar në universitetet dhe organizatat kërkimore sllovaqe në Sllovaki.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të aplikojnë online deri më **31 Tetor 2024** në orën 16:00, në faqen web: <https://www.scholarships.sk/en/> ose <http://www.stipendia.sk>. Aplikimi duhet të dorëzohet **online** (aplikanti duhet të plotësojë aplikimin online, të bashkëlidhë të gjitha dokumentet e kërkuara në formularin e përcaktuar).

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi mund të informohen më tepër dhe të aplikojnë në faqen web: www.scholarships.sk ose të kontaktojnë personat e kontaktit në adresën: nsp-foreign@saia.sk.